



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË

Numri i lëndës: 2022:016453

Datë: 19.04.2022

Numri i dokumentit: 02929903

PKR.nr. 49/22

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TE RËNDA, kryetari i trupit gjykues Shaqë Curri, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Fitore Bojku, në çështjen penale kundër të pandehurit B.D., për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 pika 11, të KPPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2, të KPPK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Pejë-Departamenti për Krime të Rënda PP/I.nr.197/12, të dt. 16.03.2022, mbajti seancën publike të shqyrtimit fillestar, me dt. 06.04.2022, të pranishëm ishin prokurori i shtetit Valbona Disha Haxhosaj, i pandehuri B.D., mbrojtësi i tij av. H.Ç., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, i dëmtuari H.P., dhe mbrojtësi i viktimave Hake Haxhaj, në të njëjtën ditë mori dhe shpalli publikisht, ndërsa me dt.19.04.2022, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I pandehuri

B.D.J i biri i dhe i nënës, e gjinisë, i lindur me dt....., në fshatin P.-T., ku edhe banon, numër personal, ka të kryer shkollën fillore, i papunë, i martuar, baba i 4 fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i R. së Shqipërisë, gjendet në paraburgim nga dt.26.01.2022.

ËSHTË FAJTOR

Për shkak se:

I. Me dt.16.05.2012, rreth orës 14:25, në rrugën R.-J., saktësisht të varrezat në lagjen në J., me dashje dhe me armë ka privuar nga jeta dy viktimat dhe atë B. P. i moshës 27 vjeçare dhe V. P. i moshës 32 vjeçare, si dhe ka plagosur rëndë të dëmtuarin N. P. i moshës 35 vjeçare, që të tre nga fsh. B. K. Gj.. Në atë mënyrë, pasi që viktimë V.P., martohet me motrën e të pandehurve, R. D., e cila në atë kohë ka qene e martuar në J. për B. T., dhe me të njëjtën jeton 2 vite dhe pas dy viteve, R. martohet me nipin e viktimës V., M. R., ashtu për shkak të këtyre martesave,

raportet acarohen ne mese te familjes se te pandehurit dhe familjes se viktimave P., ku dy vite para ditës kritike, edhe janë përleshur fizikisht mes veti, me çrast ditën kritike përderisa viktimat B., V. dhe N. P. ishin me automjetin e tyre te tipit duke shkuar nga D. për ne fsh. B. dhe me të arritur te varrezat ne lagjen ...në J., vërehen nga i pandehuri B. dhe i dënuari Sh., i cili ka qene duke e drejtuar automjetin e tipit me numër te targave, i njëjti e tejkalon automjetin e viktimave duke ju dal përpara dhe bllokuar rrugën, me çrast nga automjeti i viktimave fillimisht del i dëmtuari N. P., i cili posa afrohet të pandehurit B. për të biseduar, nga prapa në kokë goditet me bisht te sëpatës nga i dënuari Sh. dhe pasi qe rrezohet në tokë, të dëmtuarit N. i afrohet i pandehuri B. i cili gjuan me revole dy herë në drejtim të tij, duke e plagos ne dorë dhe ne abdomen, e me pas i pandehuri B. gjuan me revole, ku me një predhë e godet për vdekje në gjoks viktimën B. dhe në momentin kur viktimia V. tenton të ik, i njëjti goditet me dy predha nga pas, nga i pandehuri B.D., ku gjatë rrugës për në Spital viktimia V. ndërron jetë.

-me çka ka kryer veprën penale, të vrasjes se rënde nga neni 147 pika 11 të KPPK-së.

II. Me parë ka siguruar dhe gjerë me dt. 16.05.2012, në J., pa autorizim ka mbajtur armën dhe municionin dhe atë pistoletën te kalibrit dhe tipit te panjohur e me te cilën armë, ditën kritike i ka privuar nga jeta tani te ndjerët B. dhe V. P., ndërsa e ka plagosur te dëmtuarin N.P., qe te tre nga fsh. B. K. G..

-me çka ka kryer vepër penale, mbajtja ne pronësi, kontroll, posedim apo shfrytëzim të pa autorizuar te armëve nga neni 328 par.2 të KPPK-së.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 6, 11,15,34, 36,37,64,65,71 par 2 pika 1, nenit 147 pika 11 dhe neni 328 par.1 të KPPK-së, nenin 365, të KPP-së, të pandehurin e:

Gjykon

I. Për veprën penale nga dispozitivi i I (parë), i këtij aktgjykimi i shqipton, Dënim me burg afatgjatë, në kohëzgjatje prej 27 (njëzet e shtatë) vite, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim.

II.Për veprën penale nga dispozitivi i II (dytë) i këtij aktgjykimi i shqipton, Dënim me burg afatgjatë, në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muaj, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim

Konform nenit 71 par 1 dhe par 2 pika 1 të KPPK-së, të pandehurin e gjykon me, Dënim me burg afatgjatë në kohëzgjatje prej 27 (njëzet e shtatë) vite, e në të cilin dënim do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim (nga dita e arrestimit te tij ne shtetin e Belgjikës me dt. 08.07.2021), e të cilin dënim i pandehuri, do ta mbajë pas plotfuqishmërisë se këtij aktgjykimi.

I pandehuri obligohet që në emër të, shpenzimeve të paushallit gjyqësor të paguaj shumën prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

I pandehuri obligohet që në emër të, taksës për kompensimin e viktimave të krimit në shumë prej 50 (pesëdhjetë) euro, në afat prej 30 ditësh, pas plotfuqishmërisë së aktgjykimit.

Të dëmtuarit N. P. dhe H.P., për realizimin e kërkesës pasurore juridike udhëzohen ne kontest civil

A r s y e t i m

Prokuroria Themelore në Pejë-Departamenti për Krime te Rënda, ka ngrit aktakuzë PP/I.nr.197/12, të dt. 16.03.2022, kundër të pandehurit B.D., për shkak të veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 pika 11, të KPPK-së dhe veprës penale mbajtja në pronësi, kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve, nga neni 328 par.2, të KPPK-së.

Konform nenit 245 të KPP-së me dt. 06.04.2022, është mbajtur seanca publike e shqyrtimit fillestar dhe të pranishëm kanë qenë prokurori i shtetit Valbona Disha Haxhosaj, i pandehuri B.D., mbrojtësi i tij av. H.Ç., sipas autorizimit në shkresat e lëndës, i dëmtuari H.P., dhe mbrojtësi i viktimave Hake Haxhaj, ndërsa ka munguar i dëmtuari, N. P., i cili ka qenë i njoftuar ne mënyrë t rregullt.

Gjykata konform dispozitave te nenit 246 par. 1, të KPP-së, e ka njoftuar të pandehurin me të drejtat e tij, ku në këtë rast i pandehuri deklaroi se i ka kuptuar këto të drejta dhe ka shtuar se për mbrojtës e ka angazhuar av. H. Ç., sipas autorizimit.

Pas leximit të aktakuzës nga prokurori i shtetit, kryetari i trupit gjykues, pasi që është bindur se i pandehuri e ka kuptuar aktakuzën, i ka dhënë mundësi të pandehurit qe të deklarohet për pranimin ose mospranimin e fajësisë, duke e njoftuar për rëndësinë dhe pasojat e pranimit të fajësisë.

I pandehuri B.D. është deklaruar se, e pranon fajësinë, për veprën penale të vrasjes së rëndë nga neni 147 pika 11, të KPPK-së, po ashtu e pranon fajësinë për veprën penale mbajtja në pronësi kontroll, apo posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2, të KPPK-së. Sa i përket dënimi i pandehuri deklaroi se, nuk ka çka të shtojë, iu kërkon shumë falje familjes P., është shumë i penduar për veprat që kanë ndodh dhe e mbështet fjalën e mbrojtësit të tij.

Mbrojtësi i të pandehurit Av. H. Ç., deklaroi, se të gjithë e dëgjuan se i mbrojturi i tij e pranoi fajësinë për të dy pikat e aktakuzës, andaj kërkon nga gjykata që të bëjë pranimin e fajësisë nga ana e të mbrojturit të tij. Lidhur me dënimin kërkoi nga gjykata qe ti ketë parasysh rrethanat lehtësuese, me rastin e marrjes dhe matjes së vendimit mbi dënim. I mbrojturi i tij, është penduar thellë për atë që i ka ndodhur ditën kritike në vendin dhe në kohën siç është përshkruar në aktakuzë. Sipas traditave të vendit, familja P. i ka shtri dorën e pajtimit familjes D. dhe atë i ka falur gjakun për një vrasje dhe një tentim vrasje që u ka ndodh ditën kritike. I mbrojturi i tij, kurrë më parë nuk ka ra ndesh me ligjin, çka nënkupton se ky është rasti i parë që i ka ndodh në jetën e tij. Fakt tjetër i pamohueshëm dhe që duhet konstatuar është se i njëjti rrjedh prej një familje skajshmërisht te varfër, jetojnë dhe kanë jetuar nga puna e krahut, se i njëjti është baba i katër fëmijëve të vegjël të cilët tani për tani gjenden në botën e jashtme nën mëshirën e të tjerëve për përkujdesje për ushqim etj. I mbrojturi i tij, i kërkon falje publike familjes së dëmtuar. Ka kaluar një kohë e gjatë nga koha e kryerjes së veprës penale e deri me tani. Kërkon nga gjykata

që të mbrojturit të tij, ti shqiptojë një dënim sa më të arsyeshëm ligjor, si dhe ta lirojë të njëjtin nga shpenzimet e procedurës penale bazuar në faktin e pamohueshëm se i mbrojturi i tij ekonomikisht është i gjendjes së dobët.

Prokurori i shtetit, deklaroi se meqenëse i pandehuri, e pranoi fajësinë për dy veprat për të cilat është akuzuar nga prokuroria e i cili pranim ka mbështetje edhe në provat në bazë të cilave është ngrit aktakuza, i propozoi gjykatës që ta pranoi, pranimin e fajësisë nga i pandehuri. Lidhur me vendimin mbi dënim deklaroi se, meqenëse i pandehuri B.D., e pranoi fajësinë për dy veprat penale, për të cilat është akuzuar nga prokuroria e të cilin pranim e ka bërë edhe në prokurori, i propozoi gjykatës të pandehurin ta shpall fajtor, ta dënojë sipas ligjit, si dhe ta obligojë në kompensimin e shpenzimeve procedurale. Me rastin e marrjes së vendimit mbi dënim për të pandehurin B.D., gjykata si rrethanë lehtësuese të vlerësojë, pranimin e fajësisë në prokurori edhe poashtu edhe sot në shqyrtimin fillestar, mosdënueshmërinë e tij të mëparshme, kurse si rrethana rënduese, gjykata ta vlerësojë dhimbjen shpirtërore, që kanë pësuar dy familjet e viktimave, si dhe arratisjen nga vendi i ngjarjes, me qëllim që ti shmanget organeve të drejtësisë për veprat penale të cilat i ka kryer.

Mbrojtësja e viktimave Hake Haxhaj, deklaroi se, e mbështet në tërësi fjalën e prokurores si për rrethanat dhe provat rëndësuese dhe lehtësuese

I dëmtuari H.P., deklaroi se, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ndërsa nuk paraqet kërkesë pasurore juridike. Sa i përket dënimit deklaroi se, nuk ka çka të shton, e përkrah fjalën e prokurores së shtetit.

Kryetari i trupit gjykues, është i bindur, se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit është bërë konform dispozitave të nenit 246 dhe 248 par 1 të KPP-së, pasi që i pandehuri e kupton natyrën dhe pasojat e pranimin të fajit, pranimi i fajit mbështetet në faktet e çështjes dhe provat në të cilat edhe mbështet aktakuza, siç janë: raportet te oficerëve policor: Ahmet Hulaj dt.16.05.2012, Driton Beqiraj e dt. 16.05.2012, Asllan Idrizi dhe Sokol Halilaj e dt. 16.05.2012, Enis Boshtrakaj dt. 22.05.2012, Imer Hylaj e dt. 16.05.2012, Alberim Mujaj e dt.21.05.2012, deklarata e dëshmitarit tani të ndjerit N. P. e dhënë në polici me dt.22.05.2012, lista e dëshmimeve te marra ne vendin e ngjarjes me dt. 16.05.2020, plotësimi i kallëzimit penal mbi analizën e listingjeve të dt. 23.05.2013, plotësimi i kallëzimit penal lidhur me analizimin e masave te fshehta të dt.18.05.2012, raportin e ekspertizës – analiza te ADN-së me nr AKF/2012-1473/2012-1281 dt. 13.06.2012, raportet e ekspertizës se armëve te zjarrit me numër AKF/2012-1473/2012-1280 dt. 05.06.2012, raporti i autopsisë me nr.MA 12-111 i punuar per viktimën B. P., raporti i autopsisë me nr.MA12-112 i punuar për viktimën V. P., raporti i këqyrjes se vendit te ngjarjes e dt.16.05.2012 ora 14:20 min, foto albumi i ekzaminimit te veturës me ngjyre te bardhe, me targa, foto albumi i ekzaminimit te veturës me targa (të cilën e ka drejtuar i denuari Sh.) te dt.18.05.2012, skica e vendit te ngjarjes, tabela e matjeve ne vendin e ngjarjes, aktvendimin e Gjykares Komunale për Kundërvajtje ne Deçan me nr.01-1240/2009 te dt.06.07.2009, aktvendimin i Gjykatës për Kundërvajtje ne Deçan me nr.01-1240/2009 te dt. 16.06.2009, aktgjykimi i Gjykatës se Qarkut ne Pejë P.nr. 448/09 te dt. 22.10.2009, aktgjykimi i Gjykatës Themelore ne Pejë P. Nr. 43/18 dt. 28.06.2018, raportin e policit hetues Enis Boshtrakaj e dt. 24.01.2020 se bashku me përmbajtjen e forenzikes, skicën e vendit te ngjarjes dhe foto albumin e vendit te ngjarjes, akt ekspertimi mjeko ligjor me nr. PE-08 dt. 22.05.2018 i punuar për të dëmtuarin N. P., aktgjykimin e Gjykatës Themelore ne Pejë- Departamenti per Krime te Renda P. nr. 43/18 dt. 28.06.2018, raportin mbi konsultimin neurologjik të dt. 22.01.2013 i punuar për të dëmtuarin N. P., fletëleshimin me epikirzë nga Klinika e Urologjisë me nr AMZ 3467/12 i dt. 18.05.2018 i lëshuar per të dëmtuarin N.P., si dhe shkresat e tjera te

lëndës, pastaj aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore, ose gabim faktik, prandaj gjykata konform nenit 248 par 4 të KPP-së, ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri.

Me provat e ofruara, si dhe pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit është vërtetuar gjendja faktike si në dispozitiv të aktgjykimit. Nga gjendja e vërtetuar faktike si është përshkruar në dispozitiv të aktgjykimit, pa dyshim rrjedh se në veprimet e të pandehurit qëndrojnë të gjitha elementet e veprës penale të vrasjes së rëndë, nga neni 147 pika 11, të KPPK-së, dhe te veprës penale të mbajtjes në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 328 par.2 të KPPK-së.

Gjykata nuk gjeti rrethana që përjashtojnë ndjekjen penale apo përgjegjësinë penale të pandehurit dhe i njëjti është penalisht përgjegjës. Sa i përket fajësisë i pandehuri ishte i vetëdijshëm për veprat e kryera dhe atë i ka kryer me dashje.

Duke vendosur lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, gjykata i ka vlerësuar të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese në kuptim të nenit 64 par.1 dhe nenit 70 par 2 dhe 3 të KPRK-së. Kështu si rrethana lehtësuese për të pandehurin, gjykata mori pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, për dy veprat penale për të cilat akuzohet, kërkim faljen dhe keqardhjen e shprehur nga i pandehuri gjatë shqyrtimit fillestarë.

Rrethana rënduese ndaj të pandehurit gjykata mori shkallen e lartë të dashjes për të kryer veprën penale të vrasjes së rëndë, përkatësisht shkallen e lartë të dashjes nga ana e të pandehurit, për të ardhur deri tek pasoja e veprës penale, pasi që i pandehuri edhe pse fillimisht e godet, me dy predha të dëmtuarin N., duke e plagosur në dorë dhe në abdomen, e me pas gjuan me revole dhe me një predhë e godet për vdekje në gjoks viktimën B., dhe në momentin kur viktimë V. tenton të ik, i pandehuri e godet me dy predha nga pas, pra gjykata vlerësoi si rrethanë rënduese faktin se i pandehuri edhe pse e ka parë, tani të ndjerin V. duke tentuar të ik, prapë se prapë ka shtënë në drejtim të tij, duke e goditur nga pas dy herë, duke treguar me këtë rast, shkallë të lartë të dashjes për të ardhur deri tek pasoja e kësaj vepre, e që është privimi nga jeta e tani të ndjerëve B. dhe V. P. dhe plagosje e të dëmtuarit N.P.. Po ashtu gjykata rrethanë rënduese mori, intensitetin e rrezikimit apo të dëmtimit të vlerës së mbrojtur për faktin se në këtë rast viktimat e veprës penale kanë qenë të moshës relativisht të re, përkatësisht në këtë rast kanë humbur jetën, B. P. i moshës 27 vjeçare dhe V. P. i moshës 32 vjeçare, si dhe është plagosur rëndë i dëmtuari N.P. i moshës 35 vjeçare. Rrethanë tjetër rënduese, gjykata mori faktin se i pandehuri edhe pse ka qenë i vetëdijshëm për veprën e kryer, për afro 10 (dhjetë) vite, ka qenë në arrati dhe ka qenë i pa qasshëm për organet e drejtësisë, deri me momenti kur i njëjti është arrestua në B.. sipas urdhër arrestit ndërkombëtarë, ku edhe është bërë ekstradimi i tij për në Republikën e Kosovës.

Sipas bindjes së gjyqtarit, dënimi i shqiptuar, duke i marrë për bazë rrethanat e përmendura më lartë, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit. Gjyqtari i vetëm gjykues, gjithashtu ka konstatuar se me këto dënime mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 34 i KPPK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij; dhe të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale.

Konform nenit 73 të KPPK-së ku parashihet se, “Koha e kaluar në paraburgim si dhe çdo periudhë e heqjes nga liria lidhur me veprën penale llogariten në dënimin e shqiptuar me burgim, me burgim

afatgjatë dhe me dënim me gjobë”, te pandehurit në dënimin e shqiptuar do ti llogaritet edhe koha e kaluar ne paraburgim qe nga data e arrestimit te tij, në shtetin e Belgjikës me dt. 08.07.2021.

Duke u bazuar ne nenin 450 par. 1 dhe 2 nën par. 2.6 të KPP-se, gjykata ka përcaktuar paushallin gjyqësor në shumë prej 50 euro, duke u bazuar ne shpenzimet qe janë shkaktuar nga fillimi i kësaj procedure e deri ne përfundimin e saj.

Konform nenit 39 par.1, 2, 3, nënpar.3.2, të ligjit për kompensimin e viktimave të krimit, e obligoi në pagesën e taksë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Konform nenit 463 par. 2 të KPP-së, për realizimin e kërkesës pasurore juridike të dëmtuarit i udhëzoi në kontest civil.

Nga arsyet e cekura më lartë konform nenit 365 të KPP-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, ndërsa konform nenit 370 të KPP-së, gjykata përpiloi këtë aktgjykim.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË-DEPARTAMENTI PËR KRIME TE RËNDA
PKR.nr.49/22 dt.19.04.2022

Sekretarja Juridike

Fitore Bojku

Kryetari i Trupit Gjyqësor

Shaqë Curri

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e marrjes, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, e nëpërmjet të kësaj gjykate.
